

-VI- Nr. i prot. 13 Br. prot. Më 14.01.2021  
RAHOVEC - ORAHOVAC



Datë/Datum/Date:	12.01.2021
Referenc-ë	
CC	
Për/Za/To:	
Nga/Od/From:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Rahovec
Subjekti/Predmet/Subject:	Raporti vjetor i punës 2020

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, gjatë tremujorit të parë vitit 2020 ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë.

Fushë veprimtaria e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në Planin e Punës për vitin 2020, ky raport përfshin në mënyrë gjithpërfshirëse shërbimet e ofruara në fushën e kujdesit parësor shëndetësor si dhe atë të veprimtarisë sociale, të arriturat dhe vështirësitet e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

### Tremujori i parë: janar, shkurt, mars 2020

DSHMS qysh në fillim të vitit 2020 ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të përgjegjësive të përshkruara, kemi realizuar gjithë aktivitetet e planikuara, janë mbështetur projektet në të gjitha fushat e veprimit- shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

Në kuadër të bashkëpunimit me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, është rritur bashkëpunimi në shumë fusha, për të formësuar këtë bashkëpunim nga ana e Kryetarit të Komunës jemi ne prag të nënshkrimit të marëveshjes për ofrimin e shërbimeve mjekësore - programi "Home Care- Kujdesi Shtëpiak" për persona në nevojë, persona në regjim shtrati, ku janë angazhuar 50 punëtorë shëndetësor. Për dallim nga herat e tjera, kjo marrëveshje është duke u zhvilluar me procedurë të prokurimit, pas vërejtjeve të dhëna nga Auditori Gjeneral, pasi që më herët kjo marrëveshje është nënshkruar vetëm me negocim.

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, shërbimet mjekësore me dy ndërrime tanimë janë të përhershme, me situaten e krijuar pandemike me COVID-19, në këto dy QMF, edhe ditëve të shtune e kemi zgjatur orarin e regullt deri në kalim te situate pandemike me COVID-19.

Në fshatrat Dejnë dhe Ratkoc është shënuar përvjetori i dhurimit vullnetar të gjakut, poashtu dhurimi vullnetar i gjakut ka vazhduar edhe në fshatrat tjera të komunës son.

Në të gjitha shkollat e komunës së Rahovecit janë mbajtur ligjërata për vetëdijesimin e popullatës kundër pickimit të rriqave, dhe vetëdijesim të popullatës kundër COVID-19.

Muaji Mars 2020 e karakterizon me Pandemin globale me Coronavirus COVID-19, si drejtori dhe si komunë jemi duke i ballafaqur me këtë pandemi, me vendim të kryetarit të komunës është kriju shtabi i emergjencës, si drejtori i kemi ndërmarr të gjitha masat mbrojtëse kundër COVID-19, kemi bërë dezinfektimin e të gjitha objekteve shëndetësore QKMF, QMF-të, AMF-të, objektet e administrates komunale, të gjitha objektet fetare, Xhamit, Teqet, Stacioni i Autobusave, Objeti i Gjykatës, stacioni Policor, si dhe të gjitha rugët dhe rugicat e qytetit dhe fshatrave të komunës së Rahovecit.

Vlen të theksohet se objektet shëndetësore dezinfektohet qdo vikend, ndërsa reparti i mjekësisë familjare dhe kujdestaria dezinfektohen dy her në javë për shkak se janë reparte më të frekuentuara nga qytetarët, po ashtu si drejtori jemi ballafaqu me munges të materialit mbrojtës për personelin mjekësor si maskat mbrojtëse, dorezat, dezinfektues, teshat mbrojtëse, syzat mbrojtëse për personelin shëndetësor që janë vija e parë e frontit me COVID-19, nuk kemi furnizime të mjaftueshme nga ministria e shëndetësisë, me këkesë të kryetarit të komunës zt. Smajl Latifi kuvendi i komunës ka ndarë një fond emergjent me situatën e krijuar nga COVID-19, në vler prej 10,000€.

Po ashtu vlen të theksohet si drejtori kemi marë edhe një doancion nga kompania "Bodrumi i Vjetër" një sasi të konsiderushme dezinfektues për nevoajt e QKMF-së, 1000pako nga 100ml, dhe 600pako prej 500ml. Vazhdon dezinfektimi i te gjitha institucioneve shëndetësore qdo vikend ndërsa reparti i mjekësisë familjare dezinfektohet qdo ditë pune.

Edhe për kundër faktit që jemi ballafaqu me pandemi globale me COVID-19, investimet kapitale nuk jane ndalur kanë vazhduar punimet në ndërtim të QKMF-së, dhe Emergjën në Rahovec, si dhe ndërtimi i QMF-së, në Çifllak.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, gjatë vitit 2020 ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë.

Fushë veprimtaria e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në Planin e Punës për vitin 2020, ky raport përfshin në mënyrë gjithpërfshirëse shërbimet e ofruara në fushën e kujdesit parësor shëndetësor si dhe atë të veprimtarisë sociale, të arriturat dhe vështirësitë e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

### Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Brenda këtij viti është arritur të bëhet edhe avancimi i shërbimeve diagnostike, tanimë kemi të angazhuar specialist të biokimisë në laborator, po ashtu në radiologji kemi të angazhuar edhe specialist të Radiologjisë (Radiolog).

Gjatë kësaj periudhe raportuese është bërë edhe shpërndarja e mëtejme e shërbimeve, duke punësuar mjekë të përgjithshëm stomatologë dhe një fizioterapeute duke ofruar shërimë të fiziatrisë në QMF në Krushë të Madhe, tanë kemi stomatologë permanent në dy QMF-të, në Drenoc, dhe Fortesë, presim shumë shpejtë të angazhojmë stomatologë edhe në dy QMF të tjera, në Opterushë dhe Çifllak, poashtu kemi avancuar edhe në shërbimet për fizioterapeuti, që më herët nuk kemi pasur shërbime fizioterapeutike,

kemi angazhuar dy fizioterapeut permanent në QKMF, e në të ardhmen shpresojmë që shërbimet e tillë të ofrojmë edhe në QMF-të, në Ratkoc, të gjitha këto me synim kryesor ofrimin e shërbimeve sa më cilësore të kujdesit parësor shëndetësor dhe atyre të shëndetësisë publike të popullatës.

Kemi subvencionuar OJQ-të, që merren me veprimtaritë sociale, si shoqatat: "Hareja", "Hendikos" dhe shumë shoqata të tjera.

*Të arriturat gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020: Me "KOSOVA MED", është duke zhvilluar projekt "Home Care" që ka për qëllim realizimin e vizitave shtëpiake personave në regjim shtrati, në mungesë të stafit brenda QKMF-së për të ofruar shërbime shëndetësore, ky projekt poashtu ka zbutur shumë edhe mungesën e vazhdueshme të stafit në QKMF.*

*Është nënshkru kontrata për ndërtim të QMF-së në vler prej 81,543€ investim nga komuna, përkatësisht Drejtorisë së Shëndetësie dhe Përkujdesje Sociale.*

*Po ashtu vlen të theksohet se ekipet tona mjekësore mjek, teknik dhe infermier kane kujdestaruua në kufi në Vërmic për kontrollat mjekësore për parandalim të përhapjes së Covid-19.*

### **Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator**

Periudhën e tretë të vitit 2020 e ka karakterizuar furnizimi me vaksinat kundër gripit sezonal për të moshuarit, përcjellja e projekteve të investimeve kapitale në këtë tremujor të tret te 2020, si dhe shpërndarja në mënyrë të drejtë e subvencioneve për ndihma momentale.

Ekipi i vegant mjekësor edhe në këtë periudhë ka vazhduar me kontrollat mjekësore të të prekurëve me Covid-19, në inspektimet të regullta nga inspektorati i MSH, kemi marë vlersimet maximale për zbatim të regullave të dala nga IKSHP, për parandalim të përhapjes së Covis-19.

Furnizim me material dhe barna esenciale ka qenë i knaqshëm nga MSH, po ashtu vlen të theksohet si QKMF, përkatësisht si DSHPS nuk kemi pas probleme me furnizim me oksigen për nevoajt tëpacietëve.

Në këtë periudhe përkatësisht në Shtator është përruru objekti i ri i QMF-së, në Qifllak investim nga komuna përkatësisht nga DSHPS, në vler prej 91.292€

### **Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor**

Ne bashkëpunim me AQH-në, kemi vazhduar zbatim të Master Planin për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Komunën e Rahovecit, për periudhën 2020 /2024, Master Plani për Kujdesin Parësor Shëndetësor , është miratuar edhe në Kuvendin Komunal të Rahovecit.

Me kohë QKMF, QMF, dhe AMF-të, janë furnizu me lëndët djegëse për ngrohje për sezonën e dimërit.

Fokus i periudhës së fundit të vitit ka qenë përcjellja e punimeve në investime kapitale, sigurisht se prioritet kryesor ishte realizimi i buxhetit, jemi kujdesur që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikëri.

Është përruru objekti i ri i QKMF-së, dhe Emergjencës, në vler prej 918,886€ investim i buxhetit komunal një projekt madhor i DSHPS, me këtë objekt me 1200m<sup>2</sup> janë krijuar kushtet për punë për stafin shëndetësor duke iu ofruar shërbime sa më cilësore për pacientët në nevoj.

**Të arriturat gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2020: Në Çifllak, u bë përrimi i fillimit të punimeve për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare! Ky projekt, që kap vlerën e 91.292€ është shumë i rëndësishëm për banorët e kësaj ane dhe qasjen e tyre më të lehtë në shëndetësi, si një sektor jetik për mirëqenien e qytetarëve, përrimi i objektit të QKMF-së, dhe emergjenës me sipërfaqe prej 1200m<sup>2</sup>, investim i komunës në vler prej 918,886€.**

#### **Është bërë shpërndarja e materiat ndërtimor për familje në nevoj në vler prej 22,448€**

Viti 2020 është karakterizuar me një buxhet të konsoliduar dhe me shpenzime racionale të tij por edhe me sfida e vështirësi.

#### Mirëgenia Sociale:

Në kuadër të aktivitetave nga fusha e mirëqenies sociale janë zhvilluar aktivitetet e parapara nga kjo fushëveprimtari, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Komisionet kanë punuar vazhdimesh në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimesh në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendor dhe të huaj, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia.

Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

#### Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Ndërtimi i QMF-së, në Apterush projekti deri më tanë është përfunduar 70%, besojmë që deri ne Prill 2021 dotë përfundoj, ku dotë ofrohen shërbime sa më cilësore për qytetarët në nevoj.
- Ka përfunduar ndërtimi i QKMF, dhe Emergences , po ashtu ka perfunduar edhe ndërtimi i objektit te QMF, ne Qifllak.
- Dihitalizimi I Radiologjise, është furnizuar QKMF-ja, me paisje me modern të EHO, për radiaologji, Gjinokologji, dhe Urologji, po ashtu deri ne Mars 2021 dotë furnizohemi edhe me Mamograf per diagnostifikim të hershë të Kancerit të gjirit, dhe Ortopan për nevojat e stomatologjise

#### Sfidat e DSHM-së:

- Sfidë edhe për vitin 2021 mbetet funksionalizimi dhe hapja e Repartit të Hemodializës, pasi që nuk është paraparë me kohë Njësia e Transfuzionit të Gjakut e cila do të shërbejë për nevojat e patientëve në dializë, ne si DSHMS këtë njësi kemi në plan ta hapim në bashkëpunim me Transfuzionin Kombëtar të Gjakut ;
- Numër i pamjaftueshëm i stafit që reflekton në pamundësi të realizimit të plotë të disa shërbimeve shëndetësore.